VENDIM
Nr.109, datë 22.2.2006

PËR NORMËN E LEJUAR TË FAKTORIT TË FUQISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 dhe 66, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdoruesit jofamiljarë, ekzistues dhe të rinj, të energjisë elektrike, të lidhur me tension të mesëm 35 kV, 20 kV, 10 kV dhe 6 kV, janë të detyruar të marrin të gjitha masat, teknike dhe organizative, për të siguruar një faktor fuqie, jo më të vogël se 0.9 kV.

2. Përdoruesit jofamiljarë, ekzistues dhe të rinj, të energjisë elektrike, të lidhur me tension të ulët 0.4 kV dhe me fuqi të instaluar mbi 50 kW, janë të detyruar të marrin të gjitha masat, teknike dhe organizative, për të siguruar një faktor fuqie, jo më të vogël se 0.9 kV.

3. KESH sh.a. të instalojë aparate matës të energjisë aktive dhe reaktive, për kontrollin e faktorit të fuqisë, në të gjithë përdoruesit e përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi.

4. Kontrolli, kolaudimi dhe vulosja e aparateve matës, të bëhet nga strukturat përkatëse të KESH sh.a. sipas kodit të matjes.

5. KESH sh.a. t'i propozojë ERE-s, bazuar në kodin e matjes për plotësimin nga ana e përdoruesve të energjisë elektrike të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, tarifat e energjisë reaktive.

6. Zbatimi tarifave të energjisë reaktive të fillojë nga data 1 tetor 2006.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha